



# UNIVERSITETI DHE TREGU: PUNË KA, POR JO PËR TË DIPLOMUARIT

RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2024



AUTOR  
ILIR BRASHA

QENDRESA  
QYTETARE



NED

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



## PËRMBAJTJA

|  |    |
|--|----|
| 1. Hyrje.....  | 4  |
| 2. Të dhëna të Diplomuar sipas Fushave të Studimit.....                                    | 5  |
| 2.1. Të Diplomuar në Bachelor.....   | 5  |
| 2.2. Të diplomuar në Master ose Ekuivalent.....  | 6  |
| 2.3. Norma e Zgjedhjes së Masterit sipas fushave të Studimit.....                          | 8  |
| 2.4. Rritja mesatare e pagave sipas grup-profesioneve.....                                 | 9  |
| 3. Punë Aktive.....  | 10 |
| 3.1. Punë Aktive sipas nivelit të Kulifikimit.....   | 10 |
| 3.2. Niveli Arsimor i Popullsisë në Shqipëri.....  | 11 |
| 3.3. Punë Aktive sipas Kualifikimit, i Detajuar sipas Profilit.....                        | 11 |
| 4. Rezultatet e Anketës.....   | 14 |
| 4.1. Profili i të anketuarve:.....   | 14 |
| 4.2. Statusi i Punësimit sipas Profilit të Studimeve.....                                  | 16 |
| 4.3. Mënyra e Gjetjes së punës Aktuale.....  | 16 |
| 4.4. Vlerësimi i punës së Zyrës së Karrierës.....  | 17 |
| 4.5. Periudha e Punësimit sipas Profilit të Studimeve.....                                 | 18 |
| 4.6. Periudha e Punësimit në profesionin përkatës sipas Profilit të Studimeve.....         | 18 |
| 4.7. Arsyet e mos-punësimit në Profesionin përkatës.....                                   | 19 |
| 4.8. Lehtësia/Vështirësia e gjetjes së punës në profesion sipas Profilit të Studimeve..... | 20 |
| 4.9. Lehtësia/Vështirësia e gjetjes së punës në profesion, sipas të anketuarve.....        | 21 |
| 4.10. Përshtatja e Degës së Studimeve me Tregun e Punës.....                               | 21 |
| 4.11. Përshtatshmëria e Kurrikulave Mësimore me Tregun e Punës                             | 22 |
| 4.12. Lidhja Njohuri Universitare – Treg i Punës.....                                      | 23 |
| 4.13. Mesatarja e Përshtatshmërisë së Universitetit me Tregun e Punës në Shqipëri.....     | 23 |
| 4.14. Rekomndimi i degëve të Studimit sipas Profilit.....                                  | 24 |
| 5. Gjetje Kryesore:.....   | 25 |
| Rekomandime:.....  | 26 |
| Referenca:.....  | 26 |



## 1. HYRJJE

Ky punim ka për qëllim që të shikojë dhe identifikojë lidhjen midis studimeve në Universitete dhe lidhjen që kjo ka me tregun e punës. Për këtë qëllim janë shikuar të dhëna se cilat janë fushat e studimit që janë aktive në universitete aktualisht dhe cilat janë fushat që kërkohen në punësim. Fushat e punësimit janë marrë nga INSTAT sipas kategorisë së profilit të studimeve. Ndërkohë, nëpërmjet portaleve të punësimit, siç janë AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), Dua Punë dhe Njoftime.AL, janë marrë punët aktive dhe janë kategorizuar sipas profilit të studimeve. Kjo është realizuar për shikuar se për cilat profile studimi kemi më shumë punë aktive, pra punë të cilat kërkojnë punonjës të rinj. Në fund kemi edhe të dhëna të një pyetëtori të zhvilluar për të identifikuar pikërisht lidhjen mes tregut të punës dhe universitetit, që është edhe fokusi i këtij raporti.

Rezultatet tregojnë që degë të cilat kanë pësuar rritje më të lartë në numër studentësh nga viti 2015 në vitin 2023, janë ato që lidhen me fushën e Shërbimeve, Teknologjisë së Informacionit dhe Inxhinierisë.

Pagat të cilat tregojnë edhe nevojat për punonjës në një fushë të caktuar, kanë pësuar ndryshim/ritje më të lartë në grup-profesionet që lidhen me Teknologjinë e Informacionit. Nëse shikohen me kujdes pagat e tjera që kanë shënuar rritje, lidhen kryesisht me rritjen që ka ardhur nga ndryshimi i fashës së Pagës Minimale.

Nga monitorimi i punëve aktive në portalet e sipërpërmendura të punësimit rezulton që 53.5% e thirrjeve për punësim nuk kërkojnë për kandidatin asnjë lloj kualifikimi. Pra, pjesa më e madhe e punëve aktive janë punë në të cilat nuk kemi kriter arsimin e lartë. Ndërkohë rreth 20% janë punë të cilat kërkojnë si kriter që individët që aplikojnë për punë të kenë kryer një shkollë profesionale, ose të kenë një zanat. Për pjesën tjetër të punëve, kemi kriter diplomën universitare në një profil të caktuar sipas kërkesës. Profili më i kërkuar është ai i Ekonomistit me 8.4% të Njoftimeve të Punës, ndjekur nga IT me 1.7%, manaxherit me 1.6%, marketingut me 1.6%, si dhe fusha të ndryshme të Inxhinierisë. Pra, punët më të kërkuara lidhen pikërisht me fushat e ekonomisë dhe Inxhinierisë. Relativisht më pak punëonjës kërkohen me profile nga Drejtësia, Shkencat Sociale, Shkencat Natyrore apo Shkencat Humane.

Shkurtimisht, të dhënat nga anketa tregojnë që profilet e Ekonomistit, IT, dhe Inxhinierisë janë ato që kanë nivele më të ulëta të papunësisë, ndërkohë që e kundërta ndodh me profilet e Drejtësisë, ndonëse një pjesë relativisht e lartë e ndjekin këtë degë. Përgjithësisht, pozicionet e punës janë arritur që të gjenden më lehtë në profilin e Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Inxhinierisë, ndërkohë që e kundërta ka ndodhur me profilet e Filologjikut-Gjuhëve të Huaja dhe Juridikut. Inxhinierët, Ekonomistët, Mjekët dhe IT-të janë ata që shprehen se është më e lehtë që të gjejnë një punë në profesionin e tyre krahasuar me profilet si Filologjiku-Gjuhë të Huaja, Shkenca Sociale dhe Juridik. Edhe pse këto janë degët që mund të gjejnë punësim më lehtësisht në profesion, janë po të njëjtit të anketuar që tregojnë që këto degë, përkatësisht kurrikulat e tyre lidhën më pak me Tregun e Punës sesa për degët





e tjera, përkatësisht profilet Inxhinier, IT, Ekonomi dhe Mjek kanë kurrikula që nuk janë të përshtatura mirë me Tregun e Punës. Në rastin kur të anketuarit janë pyetur për të rekomanduar degën e tyre të studimit, rezulton që degët më të rekomanduara janë në profilin e Inxhinierit, IT, Mjekut dhe Ekonomistit.

## 2. TË DHËNA TË DIPLOMUAR SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT


Në këtë seksion do të tregohen tendencat e të diplomuarve në nivelet Bachelor dhe Master sipas fushave të studimit, si dhe do të tregohen edhe ndryshimet e pagave sipas grup-profesioneve për të shikuar se cilat profesione po kërkohen më tepër në tregun e punës.

### 2.1. Të Diplomuar në Bachelor

Degët që kanë pësuar rritje e për pasojë kanë qenë më të kërkuarat në nivelin e programeve bachelor janë degët që lidhen me fushën e Shërbimeve, ato të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Inxhinieri, Prodhim dhe Mirëqenie, si dhe Shëndet dhe Mirëqenie.

Në total rënia e numrit të të diplomuarve në programet e studimeve Bachelor ose ekuivalent është me 28% nga viti 2015 në vitin 2023. Degët që kanë pësuar rënien më të ulët në numrin e të diplomuarve janë Shkenca Sociale, Gazetaria dhe Informacioni.

**Figura 1: Të diplomuar në Bachelor ose Ekuivalent, ndryshimi 8- vjeçar në përqindje 2015-2023**




**Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori**



Ndërkohë fushat e studimit që kanë prodhuar më pak të diplomuar në vitin 2023 krahasuar me vitin 2015, rënie më të lartë e shënon Arsimi me 86% më pak të diplomuar, ndjekur nga Bujqësia, Pyje, Peshkim dhe Veterinari me 53% më pak të diplomuar, Arte dhe Shkenca Humane me 49% më pak, Shkencat Natyrore, Matematikë dhe Statistikë me 47% më pak, si dhe Biznes, Administrim dhe Ligj me 47% më pak të diplomuar në programet Bachelor ose ekuivalent.

**Figura 2: Të diplomuar në Bachelor ose Ekuivalent, ndryshimi 8 vjeçar 2015-2023**



**Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori**

## 2.2 Të diplomuar në Master ose Equivalent

Trendi i të diplomuarve në të njëjtat programe në nivelin Master ndryshon nga ai i nivelit Bachelor. Të diplomuarit në Inxhinieri, Prodhim dhe Ndërtim vazhdon po ashtu që të ketë rritje përgjatë harkut kohor 2015-2023, përkatësisht me 25%.


Po ashtu rritje shënohet edhe tek të diplomuarit në Shkenca Sociale, Gazetari dhe Informacion me 13%. Mbi nivelin mesatar shënohen edhe ndryshimet e të diplomuarve në fushën e Shëndetit dhe Mirëqënies, si dhe në fushën Biznes, Administrim dhe Ligj.

Rënia mesatare e numrit të të diplomuarve në Master ose Ekuivalent është në masën 10% nga viti 2015-2023.

Meqë rënia e numrit të të diplomuarve në bachelor ishte me 26%, kurse rënia në numrin e të diplomuarve në master ishte me 10% kjo tregon një tendencë rritje që ata studentë që mbarojnë studimet bachelor sot kanë një tendencë më të lartë sesa në të kaluarën që të përfundojnë edhe studimet master.




**Figura 3: Të diplomuar në Master ose Ekuivalent, ndryshimi 8 vjeçar në përqindje 2015-2023**



**Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori**

Degët me rënien më të lartë janë Shkencat Natyrore, Matematika dhe Statistika, të cilat shënojnë 60% më pak të diplomuar në nivelin Master ose ekuivalent. Po ashtu 60% më pak të diplomuar janë shënuar edhe në fushën e studimit të Shërbimeve, 42% më pak në fushën Arte dhe Shkenca Humane, 29% më pak në Bujqësi, Pyje, Peshkim dhe Veterinari, 21% më pak në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, si dhe një rënie me 12% në degët e Arsimit.

**Figura 4: Të diplomuar në Master ose Ekuivalent, ndryshimi 8 vjeçar 2015-2023**



**Burimi: INSTAT, përpunuar nga Autori**





## 2.3 Norma e Zgjedhjes së Masterit sipas fushave të Studimit

Për një krahasim më të saktë se sa të diplomuar në nivelin e studimit Bachelor në një fushë të caktuar zgjedhin po atë fushë kemi krahasuar të diplomuarit në Bachelor në vitin 2020 me të diplomuarit në Mastër në vitin 2023, 3 vite më vonë. Rezulton që në total 76% e të diplomuarve në nivelin Bachelor ndjekin studimet e tyre edhe në programin e studimeve Master. Në fushën e Arsimit rezulton, se ndonëse në programin Bachelor e zgjedh një numër i ulët, në programin Master janë më të shumtë ata që e zgjedhin këtë fushë studimi, përkatësisht nga 730 të dilomuar në nivelin Bachelor në vitin 2020, në vitin 2023 e kanë zgjedhur këtë fushë studimi 2,675 persona. Pra kjo tregon që nëse këta individë janë drejtuar nga tregu i punës ky profesion është i kërkuar.

Ndër degët më të kërkuara që rezultojnë ato të Shërbimeve dhe Teknologjisë së Inforamcionit dhe Komunikimit kanë një normë të ulët të studentëve që zgjedhin të diplomohen në Master kundrejt atyre që zgjedhin të diplomohen në Bachelor. Kjo mund të ndodhë edhe për shkak se ata mund të fillojnë punën që në nivelin e studimeve Bachelor pa pasur nevojë për një diplomë në nivelin e studimeve Master. Dega e Tekonologjisë së Informacionit rezulton të ketë të diplomuar në vitin 2020 në nivelin Bachelor 1,191 individë, ndërkohë që të diplomuar në master në vitin 2023 rezultojnë vetëm 387 persona. Nivele të larta diplomimi në Master kundrejt Bachelorit kanë fushat e studimit Bujqësi, Pyje, Peshkim dhe Veterinari (90%) si dhe Biznes, Administrim dhe Ligj.

**Tabela 1: Të diplomuar sipas fushave të studimit Bachelor ose ekuivalent 2020 vs Master ose ekuivalent 2023.**

|   | BACHELOR TË DIPLOMUAR 2020 | MASTER TË DIPLOMUAR 2023 | RAPORTI     |
|---|----------------------------|--------------------------|-------------|
| <b>Gjithsej: Të gjitha fushat e arsimit</b> | <b>17,585</b>              | <b>13,325</b>            | <b>0.76</b> |
| Arsim                                       | 730                        | 2,675                    | 3.66        |
| Arte dhe shkencë humane                     | 2,736                      | 667                      | 0.24        |
| Shkencë sociale, gazetari dhe informacion   | 1,666                      | 1,232                    | 0.74        |
| Biznes, administrim dhe ligj                | 5,034                      | 4,195                    | 0.83        |
| Shkencë natyrore, matematikë dhe statistikë | 940                        | 218                      | 0.23        |
| Teknologji e Informacionit dhe komunikimit  | 1,191                      | 387                      | 0.32        |
| Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim             | 1,745                      | 1,333                    | 0.76        |
| Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari       | 514                        | 465                      | 0.90        |
| Shëndet dhe mirëqenie                       | 2,889                      | 1,999                    | 0.69        |
| Shërbime                                    | 801                        | 154                      | 0.19        |

**Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit.**




## 2.4 Rritja mesatare e pagave sipas grup-profesioneve

Në grafikun e mëposhtëm është shfaqur rritja mesatare vjetore e pagave ndërmjet viteve 2018-2023 sipas grup profesioneve për të shikuar se cilat janë profesionet që kanë shënuar rritjen më të lartë dhe më të ulët si dhe për të kuptuar se për cilat profesione ka më shumë nevojë tregu. Pra, rritja e pagave tregon në një mënyrë edhe nevojën e tregut për atë profesion si dhe rritjen e kërkesës për punë.

Rritja e pagave që lidhet me profesione siç janë Prodhues të Produkteve Bujqësore, apo Blegtorale, Punëtorë Shitje dhe profesione të tjera ka ndodhur për shkak të ndryshimit të fashës së pagës minimale. Për këtë arsye këto grup-profesione ndodhen në krye të listimit. Ndërkohë, grafiku tregon qartë që pagat në profilin e Teknologjisë së Informacionit, të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Shëndetësisë etj, kanë pësuar rritje më të lartë sesa pagat në profesionet e tjera, e për pasojë tregon edhe nevojën e vendit për punësim në këto grup-profesione.

**Figura 5: Rritja mesatare vjetore e pagave 2018-2023, sipas grup-profesioneve**



**Burimi: INSTAT, përpunimi i autorit**





### 3. PUNË AKTIVE

Për të pasur një pasqyrë të përafërt të tregut të punës kemi marrë në shqyrtim 3 nga Portalet kryesore të punës në Shqipëri, përkatësisht: Portalin zyrtar të AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive), si dhe dy portale të tjera shumë të përdorura në Shqipëri siç janë Dua Punë dhe Njofftime AL.


Në të treja këto portale janë marrë në shqyrtim punët aktive nga Nëntori deri në mesin e muajit Dhjetor 2024. Në total në këto tre portale kanë rezultuar punë aktive përgjatë kësaj periudhe 2800 vende punësimi. Nga të cilat 1317 në portalin e AKPA, 705 në Dua Punë, si dhe 778 në portalin Njofftime AL.

#### 3.1. Punë Aktive sipas nivelit të Kualifikimit

Kur shikojmë të dhënat e tregut të punës, përkatësisht ato të punëve aktive në portalet e sipërpërmendura, rezulton se pjesa më e madhe e punëve nuk kërkojnë një kualifikim të caktuar. Përkatësisht 53.5% e punëve të publikuara nuk kërkojnë një kualifikim të caktuar të kandidatit gjë e cila nënkupton se ato nuk kërkojnë një nivel të përcaktuar studimesh universitare. Për më tepër një e pesta e punëve aktive në këto portale janë kërkesa për punë për punëtorë që kanë kryer një shkollë profesionale, ose që kanë një zanat të caktuar. Duke hequr këto pjesë të punëve aktive, rezulton që vetëm rreth 25%, pra një e katërta e punëve aktive në Shqipëri, janë punë të cilat kërkojnë që punëtori të ketë nivel universitar studimesh. Ndërkaq, 1.5% e punëve aktive janë të paidentifikuara, sepse nuk specifikohet në asnjë rast niveli i kualifikimit të atij që mund të aplikojë.

Norma e ulët e punëve që kërkojnë kualifikim universitar, tregon që tregu i punës në Shqipëri po kërkon më shumë punë të cilat nuk kërkojnë një kualifikim të caktuar ose punë të cilat duan një profesion, apo zanat të caktuar.

**Figura 6: Punë Aktive në Portalet e Punës: AKPA, Dua Punë dhe Njofftime AL, sipas nivelit të kualifikimit**



**Burimi: Portalet e Punës: AKPA, Dua Punë dhe Njofftime AL, përpunimi i autorit**




### 3.2 Niveli Arsimor i Popullsisë në Shqipëri

Duke shikuar të dhënat e CENS 2023, për nivelin e arsimit të popullsisë sipas grupmoshave, rezulton që rreth 23.2% e popullsisë nga 25-64 vjeç ka nivel arsimor të paktën në nivelin Bachelor (ose program i shkurtuar i lartë studimi). Vihet re që një pjesë e madhe e të rinjve tanimë zgjedhin që të ndjekin studimet e larta. Përkatësisht, duke shikuar ndarjen sipas grupmoshave, rezulton që 45% e të rinjve nga mosha 25-29 vjeç kanë të mbaruar studimet universitare. Kjo përqindje vjen në ulje duke u rritur mosha e popullsisë, këto të paraqitura edhe në Figurën.7.

Kjo tregon që niveli arsimor i kërkuar për punët aktive, shkon përshtat edhe me nivelin arsimor të popullsisë. Pra rreth 25% e punëve aktive kërkojnë punonjës të kualifikuar me arsim të lartë, dhe pothuajse aq është edhe pjesa e arsimuar e popullsisë, përkatësisht 23.2% e grupmoshës 25-64 vjeç. Ajo çfarë shikohet problematike është që të rinjtë që synojnë dhe kanë një nivel më të lartë arsimor sesa më të moshuarit, përballen me vështirësinë e gjetjes së një pune në profilin e tyre. Përkatësisht, nëse marrim vetëm grupmosha të caktuara, ku ata që ndryshojnë punë më shpesh dhe që janë në kërkim të vazhdueshëm të një pune (grupmosha 25-29 vjeç), vihet re që kanë një nivel arsimor më të lartë, përkatësisht 45%, krahasuar me vetëm 25.2% të punëve aktive që kërkojnë nivel të lartë arsimor.

**Figura 7: Niveli Arsimor i popullsisë sipas grupmoshave**



**Burimi: INSTAT, CENS 2023, përpunimi i autorit**

### 3.3 Punë Aktive sipas Kualifikimit, e Detajuar sipas Profilit

Në një detajim të punëve aktive, rezulton që profili i ekonomistit është ai që kërkohet më së tepërmi dhe ai për të cilin ka më shumë vende të lira punë gjatë periudhës së marrë në shqyrtim fillim Nëntori – gjysmë Dhjetori. Përkatësisht, 8.4% e punëve aktive, rezultojnë që të lidhen me profilin e ekonomistit (Ekonomi, Financë, Kontabilitet, Biznes). Profili që pason si më i kërkuari është ai i IT-së, përkatësisht 1.7% e punëve aktive kërkojnë pikërisht këtë profesion. Pastaj janë punë që lidhen indirekt përsëri me profilin e ekonomistit, si psh Manaxher dhe Marketing me përkatësisht 1.6% secila.





Punët që pasojnë si më të kërkuarat janë ato të lidhura me Inxhinieritë, ku kryeson Inxhinieri i Ndërtimit me 1.3%, ndjekur nga Inxhinier Elektrik me 0.9%, Arkitekt me 0.9% dhe Inxhinier Mekanik me 0.8%. Punë të lidhura indirekt me Ekonomistin, por që nuk e kanë të specifikuar në kriteret e punësimit profilin e ekonomisë është edhe puna si Arkëtar, që zën 1.3% të punëve Aktive.

Në një analizë të thjeshtë duket që punët me profil Ekonomik, Inxhinier dhe IT, janë ato që kërkohen më shumë nga punëdhënësit, ndërkohë që punë të tjera që lidhen me shkencë sociale, arsim apo fusha të tjera jo të sipërcitura, kanë ofertë relativisht të ulët punësimi në profesion.


Edhe profesioni i juristit edhe pse prodhon relativisht një numër të lartë të diplomuarisht vit pas viti duket që në tregun e punës e ka të vështirë për t'u pozicionuar. Vetëm 0.5% e punëve aktive në këtë profesion rezultojnë aktive përgjatë periudhës së marrë në shqyrtim. Duhet pasur parasysh që modeli i zhvilluar në këtë raport paraqet edhe kufizime që lidhen kryesisht me:

1. Ekziston mundësia që për profesione të caktuara punëdhënësit mos të përdorin portalet e marra në shqyrtim për të gjetur punonjës.
2. Ekziston mundësia e dublikimit të punëve, edhe pse është treguar kujdes që punët e publikuara dy herë mos të përsëriten.

Një gjë interesante e vërejtur në identifikimin e punëve në portalet e marra në shqyrtim është që në AKPA, pra në Agjencinë Zyrtare Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nuk kemi oferta/publikime punësh aktive për operator telefonik/Call Center, ndërkohë që në dy portalet e tjera të marra në shqyrtim, një pjesë e madhe e njoftimeve për punësim vijnë pikërisht për këtë punë.



**Figura 8: Punë Aktive sipas Profilit**



**Burimi: Portalet AKPA, Dua Punë, Njoffime AL, periudha Nëtor – Gjysma e Dhjetorit, Përpunim i Autori**





## 4. REZULTATET E ANKETËS


Për të shikuar lidhjen midis Universitetit dhe Tregut të Punës është realizuar një anketë me 247 të anketuar të cilët kanë përfunduar studimet e tyre në 10 vitet e fundit ose janë studentë aktiv në periudhën e realizimit të pyetësorit. Anketimi është kryer në formën online, duke u shpërndarë në mënyrë të rastësishme, por nuk ka arritur që të jetë përfaqësues për të gjitha Universitetet në vend. Marzhi i gabimit për rezultatet e përgjithshme, totalin është rreth 6%.

### 4.1. Profili i të anketuarve:

Në përpjekje për të sjellë një pasqyrë më të mirë sesa lidhet tregu i punës me universitetin dhe profesionet, është realizuar një anketë ku kanë marrë pjesë 247 të anketuar. Anketimi është kryer në formën online dhe është shpërndarë në mënyrë të rastësishme tek të diplomuar gjatë 10 viteve të fundit ose student në vazhdim të studimeve të tyre në nivelin e studimeve Bachelor, Master, Program i Lartë Shkurtuar Studimi, apo Doktoraturë.

Rreth një e treta e të anketuarve janë Djem/Burra dhe 2/3 janë Vajza/Gra.

**Figura 9: Profili i të Anketuarve, sipas gjinisë**




### **Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

Më shumë se gjysma e të anketuarve, përkatësisht 52% e tyre janë studentë, apo janë diplomuar gjatë 10 viteve të fundit nga Universiteti i Tiranës. Rreth 15% e të anketuarve janë të diplomuar/Student në Universitetin Politeknik të Tiranës, 6% në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës, 5% në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Rreth 11% janë të diplomuar ose studentë në Universite Private dhe pjesa tjetër 7% janë në universitete publike të tjera që nuk u përmendën, si dhe 3% kanë mbaruar në shkolla profesionale. 1% janë studentë që kanë mbaruar jashtë vendit.




**Figura 10: Profili i të Anketuarve, sipas Universitetit ku janë diplomuar apo ku janë studentë aktiv**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

Kur shikojmë të anketuarit sipas profilit të studimeve na rezulton se të diplomuar apo studentë në profilin e ekonomisë janë 36%, ndjekuar nga ata në Drejtësi me 12%, IT me 11%, Inxhinier me 9%, Shkenca Sociale me 8%, Filologjiku – Gjuhë e Huaj me 8%, Mjekësi me 8%.


**Figura 11: Profili i të Anketuarve, sipas Profilit të studimeve**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

Të anketuarit të pyetur në lidhje me statusin e tyre të punësimit, rezulton që 47% e tyre janë të punësuar në sektorin privat, 17% të punësuar në sektorin publik, 21% janë akoma student, 5% kanë zgjedhur që të emigrojnë dhe 10% janë të papunë ose në kërkim të një pune.

**Figura 12: Profili i të Anketuarve, sipas Punësimit**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**






## 4.2 Statusi i Punësimit sipas Profilit të Studimeve

Disagregimi i statusit të punësimit sipas profilit të studimit, na tregon që dega e cila ka gjasa që të ketë nivel më të ulët punësimi është Drejtësia. Përkatësisht, 27% e të anketuarve të cilët janë profilizuar në këtë fushë studimi, nuk janë të punësuar. Dega e dytë me nivelin më të lartë të papunësisë janë degët që lidhen me Shkencat Sociale, përkatësisht 15% të papunë (të dhënat indikative dhe jo të rëndësishme statistikisht). Profile me nivele të larta papunësie janë edhe Mjekësia dhe degë që lidhen me Filologjikun dhe Gjuhët e Huaja (11%, të dhënat indikative dhe jo të rëndësishme statistikisht). Profili i studimit që duket sikur ka nivele më të larta të punësimit është Ekonomia, përkatësisht vetëm 3% janë e të anketuarve që kanë mbaruar universitetin në këtë fushë studimi janë të papunë ose në kërkim të një pune.

**Figura 13: Punësimi sipas profilit të studimit**




**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

## 4.3 Mënyra e Gjetjes së punës Aktuale

Të pytur se si e kanë gjetur punën ku janë aktualisht, ndër ata që janë aktualisht në punë, rezulton që 35% e tyre e kanë gjetur nga Sugjerime nga të njohurit e tyre. Pra, mjete kryesor i punësimit të të rinjve rezulton që të jetë pikërisht sugjerimi nga një i njohur. Më tej rezulton që një e katërta ose 24% e të anketuarve të punësuar e kanë gjetur punën e tyre aktuale nëpërmjet internetit. Rreth 13% të të anketuarve të punësuar i ka kërkuar vetë punëdhënësi. Rreth 6% janë ndihmuar për të gjetur punë nga Fakulteti ose stafi i Pedagogëve, ndërkohë që vetëm 1% e të anketuarve të punësuar është ndihmuar nga Zyra e Karrierës.



**Figura 14: Mënyra e gjetjes së punës aktuale**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

#### 4.4 Vlerësimi i punës së Zyrës së Karrierës


Të anketuarit u pyetën edhe sesi e vlerësonin punën e zyrës së karrierës pranë universitetit të tyre. Ajo çfarë vlen për t'u theksuar është që një pjesë relativisht e lartë e studentëve apo të diplomuarve nuk kanë informacion mbi Zyrën e Karrierës, prandaj edhe nuk mund të japin një vlerësim për punën e saj. Përkatësisht në total të anketuar 40% e tyre nuk kanë informacion për Zyrën e Karrierës. Mungesa e informacionit shfaqet më e lartë në Universitetin e Tiranës (42%) dhe në Universitetin Politeknik të Tiranës (42%). Të dhënat për universitetet e tjera janë vetëm indikative.

Më keq puna e Zyrës së Karrierës vlerësohet në Universitetin Aleksandër Moisiu në Durrës, ku përkatësisht 46% kanë mendim që Zyra e Karrierës bën një punë "të keqe" ose "Shumë të keqe" (të dhënat janë indikative).

Më tej vlerësim më negativ ka Zyra e Karrierës në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës, përkatësisht me 42% që e vlerësojnë punën e saj si "të keqe" ose "shumë të keqe" (të dhënat indikative).

Puna e Zyrës së Karrierës në UT vlerësohet si "e keqe" ose "shumë e keqe" nga 38% e të anketuarve të këtij Universiteti.

**Figura 15: Vlerësimi i Zyrës së Karrierës sipas Universiteteve**






#### 4.5 Periudha e Punësimit sipas Profilit të Studimeve

Më shumë se gjysma e të anketuarve të cilët kanë mbaruar studimet kanë filluar punë gjatë studimeve ose menjëherë pas përfundimit të tyre, përkatësisht 56% gjatë studimeve, kurse 17% menjëherë pas studimeve. Rezultatet sipas profilit janë të rëndësishme statistikisht vetëm për profilin e Ekonomisë, ndërkohë që rezultatet për profilet e tjera janë indikative. Rezulton që degët që sjellin punësim më të shpejtë në kohë (pavarësisht llojit të punës) janë ato me profil në Shkencat Sociale, ndjekur nga Ekonomia, Inxhinieria dhe IT-ja. Ndërkohë, profili që vuan më shumë në punësim është ai që lidhet me degët në Filologjik dhe Gjuhë të Huaja.

Figura 16: Periudha e punësimit sipas profilit të studimeve



#### 4.6 Periudha e Punësimit në profesionin përkatës sipas Profilit të Studimeve


Të anketuarit që nuk janë në proces studimesh janë pyetur edhe se cila është periudha që u është dashur atyre që të gjejnë një punë në profesionin/profilin që ata kanë studiuar.

Rreth 42% e të anketuarve e kanë gjetur një punë në profesionin e tyre, gjatë studimeve ose menjëherë pas tyre. Nga ana tjetër, 13.9% e të anketuarve nuk kanë arritur që të gjejnë një punë në profilin e tyre të studimeve. Ndërkaq, 9.3% e të anketuarve kanë zgjedhur që të mos punojnë në profilin në të cilin kanë studiuar.



Të anketuarit me profil në Ekonomi janë ata të cilën e kanë gjetur më shpejt një punë në profesionin e tyre, përkatësisht 39.5% gjatë studimeve, dhe 13.6% menjëherë pas përfundimit të tyre. Rezultatet për profilet e tjera janë indikative dhe jo të rëndësishme statistikisht. Profili që praqet më shumë problematika me gjetjen e punës në profesion është ai që lidhet me degët e Filologjikut dhe Gjuhëve të Huaja.

**Figura 17: Periudha e Punësimit në Profilin përkatës**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**


#### 4.7 Arsyet e mos-punësimit në Profesionin përkatës

Të anketuarit të cilët zgjedhën alternativën që kanë zgjedhur që të bëjnë një punë tjetër jashtë profilit të studimeve u pyetën më tej se cilat janë arsyet. Rreth 43% e tyre u shprehën se “Paga” është faktori kryesor i cili ka ndikuar që ata të mos punojnë në profesion, por të punojnë në një profil i cili siguron për ta më shumë të ardhura. Rreth 24% e tyre edhe pse kanë studiuar një degë të caktuar, kur kanë dalë në tregun e punës e kanë gjetur veten e tyre në një profil tjetër. Për 19% të të anketuarve që kanë zgjedhur që të mos punojnë në profilin ku kanë studiuar, arsyeja është sepse kushtet e punës janë më të këqija në profilin ku kanë studiuar sesa në profilin ku punojnë aktualisht.





**Figura 18: Arsyet se përse kanë të anketuarit kanë zgjedhur që të bëjnë një punë tjetër nga profili i tyre**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**


#### 4.8 Lehtësia/Vështirësia e gjetjes së punës në profesion sipas Profilit të Studimeve

Të anketuarit e kanë pasur më të lehtë që të gjejnë një punë në profesionin e tyre kur kanë pasur profil Inxhinier, ndjekur nga Ekonomist, Mjek dhe IT.

Ndërkohë më të vështirë e kanë pasur që të gjejnë një punë në profesion të anketuarit që kanë mbaruar universitetin në profilet që lidhen me Shkencat Sociale, Drejtësinë, si dhe degë që lidhen me Filologjikun dhe Gjuhët e Huaja.

Pothuajse gjysma e të anketuarve që kanë mbaruar Filologjikun ose Gjuhët e Huaja e konsiderojnë që e kanë pasur shumë të vështirë për të gjetur një punë në profesionin e tyre (përkatësisht 47.1% e tyre).

**Figura 19: Sa të lehtë/vështirë e kanë pasur të anketuarit për të gjetur një punë në profesionin e tyre.**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**




#### 4.9 Lehtësia/Vështirësia e gjetjes së punës në profesion, sipas të anketuarve

Për të shikuar rezultatet në një kontekst tjetër, të anketuarit janë pyetur se sa të vështirë mendojnë ata që mund ta ketë një individ që ka studiuar të njëjtën degë si ata për të gjetur një punë në profesion. Rezultatet tregojnë që më pozitiv janë të anketuarit që studiojnë IT, ndjekuar nga ata që studiojnë Inxhinier, Mjekësi, dhe Ekonomi. Pra për këto profile, të anketuarit mendojnë që është më e lehtë që një person të gjej punë. Ndërkohë profile që kanë të bëjnë me Shkencat Sociale, Filologjikun dhe Gjuhët e Huaja si dhe Drejtësinë, shikohen si profile më të vështira për një individ që të gjej punë në profesion.

Duhet pasur parasysh se kur marrim në shqyrtim të dhënat e disagreguara, përpos profilit të Ekonomisë ku rezultatet janë statistikisht të rëndësishme, për rastet e tjera i kemi vetëm indikative.

**Figura 20: Sa të lehtë/vështirë e kanë individët që kanë studiuar njësoj si i anketuari që të gjej punë në profesion**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

#### 4.10 Përshatja e Degës së Studimeve me Tregun e Punës


Kur të anketuarit u pyetën se sa përshatet dega e tyre e studimit me tregun e punës, rezultoni që Profili i IT, Ekonomisë, dhe Mjekësisë janë ata që kanë përshatjen më të lartë me tregun e punës. Më dobët nga të anketuarit vlerësohen degët e Shkencave Sociale dhe të Inxhinirisë, si degë që nuk përshatën me tregun e punës.

Duhet theksuar që të dhënat janë statistikisht të rëndësishme vetëm për Profilin e Ekonomisë, dhe Drejtësisë. Rezultatet e tjera janë indikative.

**Figura 21: Sa mendojnë të anketuarit që dega e tyre e studimit përshatet me tregun e punës?**







**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**


#### 4.11 Përshtatshmëria e Kurrikulave Mësimore me Tregun e Punës

Kur të anketuarit pyeten se si e vlerësojnë përshtatshmërinë e Kurrikulave mësimore me Tregun e punës, rezultoni që pikërisht në degët që është më e lehtë të gjejsh punë, siç janë Inxhinieria, IT, apo Ekonomia, këto kurrikula vlerësohen si më pak të përshtatshme krahasuar me degët e tjera. Ndërkohë, degët për të cilat është më e vështirë që të gjendet një punë në profesionin aty në Drejtësi, Shkenca Sociale, apo Filologjiku dhe Gjuhë të Huaja, kurrikulat vlerësohen si më të përshtatshme.

Mbi 17% e të anketuarve me profil Inxhinier i vlerësojnë kurrikulat mësimore në këtë profil si Plotësisht të papërshtatshme.

Duhet theksuar se rezultatet janë të rëndësishme statistikisht për profilin e Ekonomisë, Drejtësisë, kurse për të tjerat janë Indikative.

**Figura 22: Si i vlerësojnë të anketuarit përshtatshmërinë e Kurrikulave mësimore në lidhje me tregun e punës?**




**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**



#### 4.12 Lidhja Njohuri Universitare – Treg i Punës

Të anketuarit janë pyetur edhe se sa i ndihmojnë ata informacionet dhe dijet e marra gjatë studimeve, në Tregun e Punës. Të anketuarit me profil në Mjekësi shprehen se informacionet dhe dijet e marra përgjatë studimeve i ndihmojnë më shumë në Tregun e Punës sesa të anketuarit në profile të tjera. Në rradhë pason profili i Drejtësisë, ku të anketuarit në këtë profil vlerësojnë se njohuritë e tyre i ndihmojnë ata në Tregun e Punës. Më pak i ndihmojnë njohuritë e marra gjatë studimeve, të anketuarit me profil në Inxhinieri, dhe Shkenca Sociale. Përkatësisht, 13% e të anketuarve në Inxhinieri vlerësojnë se njohuritë e marra përgjatë studimeve nuk i ndihmojnë aspak në tregun e punës. Po ashtu 7.1% e të anketuarve në IT, vlerësojnë se njohuritë e marra gjatë studimeve nuk i ndihmojnë në Tregun e Punës.

**Figura 23: Sa i ndihmojnë të anketuarit Informacionet/Dijet e marra në Universitet në Tregun e Punës?**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**


#### 4.13 Mesatarja e Përshtatshmërisë së Universitetit me Tregun e Punës në Shqipëri

Kur të anketuarit pyeten se sa përshtaten në përgjithësi degët nëpër universitete me Tregun e Punës në Shqipëri, në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 është nuk "Përshtaten Aspak", dhe 10 është "Përshtaten Plotësisht", rezulton një mesatare prej 4.83 pikësh, pra më pak se gjysma, që do të thotë që pjesa më e madhe e të anketuarve mendon që Degët nëpër Universitete përshtaten në mënyrë të moderuar me Tregun e Punës. Të anketuar me profil studimesh në Drejtësi, Mjekësi dhe Inxhinieri mendojnë që përshtaten më shumë kurrikulat nëpër universitete me tregun e punës. Ndërkohë e kundërta ndodh me të anketuarit me profil në Filologjik-Gjuhë të Huaja dhe Shkenca Sociale.





**Figura 24: Në një shkallë nga 1 në 10 sa mendoni se përshtaten degët nëpër Universitete me Tregun e Punës në Shqipëri?**




**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**

#### 4.14 Rekomndimi i degëve të Studimit sipas Profilit

Të anketuarit janë pyetur edhe sa do t'ia rekomandonin një të afërmi apo të njohuri që të ndiqte degën e studimit që ata kanë mbaruar apo janë në proces studimi. Në një mesatare nga 1 në 10, ku 1 është "Nuk do ta Rekomandoja Aspak" dhe 10 është do ta "Rekomandoja Plotësisht", rezulton që të anketuarit mesatarisht e rekomandojnë 5.89 pikë. Rekomandimi qëndron afër mesatares, pra kemi një rekomandim të moderuar. Më shumë e rekomandojnë degën e tyre ata që kanë studiuar apo studiojnë Inxhinieri, IT, dhe Mjekësi. Ndërkohë e kundërta ndodh me profilet e Filologjikut-Gjuhëve të Huaja, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, degë të cilat rekomandohen që të ndiqen më pak sesa të tjerat.

**Figura 25: Në një shkallë nga 1 në 10, sa do t'ia rekomandonit një të afërmi apo të njohuri që të vazhdonte degën e studimit që ju keni përfunduar?**



**Burimi: Anketa, Përpunim i Autorit**



## 5. GJETJE KRYESORE:

Rezultatet tregojnë që degë të cilat kanë pësuar rritje më të lartë në numër studentësh nga viti 2015 në vitin 2023 janë ato që lidhen me fushën e Shërbimeve, Teknologjisë së Informacionit, dhe Inxhinierisë.

Pagat të cilat tregojnë edhe nevojat për punonjës në një fushë të caktuar, kanë pësuar ndryshim/ritje më të lartë në grup-profesionet që lidhen me Teknologjinë e Informacionit. Nëse shikohen me kujdes pagat e tjera që kanë shënuar rritje, lidhen kryesisht me rritjen që ka ardhur nga ndryshimi i fashës së Pagës Minimale.

Nga monitorimi i punëve aktive në portalet e punësimit: AKPA, Dua Punë dhe Njofftime.AL, rezulton që 53.5% e thirrjeve për punësim nuk kërkojnë për kandidatin asnjë lloj kualifikimi. Pra, pjesa më e madhe e punëve aktive janë punë në të cilat nuk kemi kriter arsimit të lartë. Ndërkohë rreth 20% janë punë të cilat kërkojnë si kriter që individët që aplikojnë për punë të kenë kryer një shkollë profesionale, ose të kenë një zanat. Për pjesën tjetër të punëve, kemi kriter diplomën universitare në një profil të caktuar sipas kërkesës. Profili më i kërkuar është ai i Ekonomistit me 8.4% të Njofftimeve të Punës, ndjekur nga IT me 1.7%, manaxherit me 1.6%, marketingut me 1.6%, si dhe fusha të ndryshme të Inxhinierisë. Pra, punët më të kërkuara lidhen pikërisht me fushat e ekonomisë dhe Inxhinierisë. Relativisht më pak punëonjës kërkojnë me profile nga Drejtësia, Shkencat Sociale, Shkencat Natyrore apo Shkencat Humane.

Shkurtimisht, të dhënat nga anketa tregojnë që profilet e Ekonomistit, IT, dhe Inxhinierisë janë ato që kanë nivele më të ulëta të Papunësisë, ndërkohë që e kundërta ndodh me profilin e Drejtësisë, edhe pse një pjesë relativisht e lartë e ndjekin si degë. Përgjithësisht, punët në profesion janë arritur që të gjenden më lehtë në profilin e Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Inxhinierisë, ndërkohë që e kundërta ka ndodhur me Profilet e Filologjikut-Gjuhëve të Huaja dhe Juridikut. Inxhinierët, Ekonomistët, mjekët dhe IT-të janë ata që shprehen se është më e lehtë që të gjejnë një punë në profesionin e tyre krahasuar me profilet si Filologjiku-Gjuhë të Huaja, Shkenca Sociale dhe Juridik. Edhe pse këto janë degët që mund të gjejnë punësim më lehtësisht në profesion, janë po të njëjtit të anketuar që tregojnë që këto degë, përkatësisht kurrikulat e tyre lidhën më pak me Tregun e Punës sesa për degët e tjera, përkatësisht profilet Inxhinier, IT, Ekonomi dhe Mjek kanë kurrikula që nuk janë të përshtatura mirë me Tregun e Punës. Në rastin kur të anketuarit janë pyetur për të rekomanduar degën e tyre të studimit, rezulton që degët më të rekomanduara janë në profilin e Inxhinierit, IT, Mjekut dhe Ekonomistit.

Si përfundim degët me më shumë mundësi në tregun e punës rezultojnë që të jenë ato të Inxhinierisë, Ekonomistit, IT dhe Mjekësisë. Ndërkohë, degë që paraqesin risk më të lartë të punësimit janë ato që lidhen me profile studimi si Shkenca Sociale, Juridik dhe Filologjik-Gjuhë të huaja.





## 6. REKOMANDIME:

- Fokusimi i Universiteve drejt Tregut të Punës, duke krijuar degë të reja sipas kërkesës dhe gjithashtu edhe përshtatja e degëve aktuale drejt tregut
- Përmirësimi i Kurrikulave Mësimore, duke sjellë një përshtatje më të lartë të tyre me nevojat dhe kërkesat e tregut
- Funkcionaliteti i Zyrës së Karrierës si ndërmjetëse dhe ndihmesë për studentët në kalimin e tyre nga studentë në të punësuar
- Duhet realizuar Studime Tregu, pasi mungojnë për të orientuar studentët drejt zgjedhjes së Degëve të Studimit që lidhen me Tregun e Punës

## 7. REFERENCA:

Të dhënat janë marrë nga INSTAT: <https://www.instat.gov.al/>

AKPA: <https://www.puna.gov.al/>

Dua Punë: <https://duapune.com/>

Njoftime AL: <https://www.njoftime.al/>

Të dhënat e tjera janë përpunim nga Pyëtëtori



#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)